

VENDIM
Nr.552, datë 27.11.1999

**PËR TRAJTIMIN EKONOMIK E FINANCIAR TË FAMILJEVE TË PUNONJËSVE TË
POLICISË, QË HUMBIN JETËN OSE PLAGOSEN PËR SHKAK TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në republikën e Shqipërisë", të neneve 24 dhe 32, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991, "Për policinë e rendit", me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Pjesëtarëve të familjes, që bashkëjeton me punonjësi e policisë, i cili ka humbur jetën, ose është plagosur në krye të detyrës, apo për shkak të saj u jepet një ndihmë e menjëhershme për çdo person, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë, për ata që ishin në ngarkim të të vdekurit dhe nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë, për ata që janë në ngarkim të plagosurit. Masa e ndihmës dhe subjektet që e përfitojnë atë miratohen me urdhër të ministrit të Rendit Publik.

Këtë ndihmë e përfitojnë edhe pjesëtrët e familjes së qytetarëve të tjerë, që humbasin jetën ose plagosen për shkak të kryerjes së detyrave në ndihmë të policisë

Pika 1 e këtij vendimi i shtrin efektet e zbatimit nga data 1 janar 1999.

2.Fëmijëve të punonjësve të policisë, që kanë humbur jetën në krye e për shkak të detyrës, kur ata vazhdojnë studimet në shkollat e mesme e të larta, bursat e tyre përballohen nga buxheti i shtetit.

Pika 2 e këtij vendimi i shtrin efektet e zbatimit nga data 1 janar 1991.

3.Në rastet kur, në bazë të kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.159, datë 20.4.1991, "Për kujdesin mjekësor të shtetit për të sëmurët që dërgohen jashtë shtetit", punonjësit e policisë dhe pjesëtarët e familjeve të tyre dërgohen për diagnostikim e kurim jashtë shtetit, të gjitha shpenzimet për viza, udhëtim, ushqim, diagnostikim, mjekim etj., që kryhen në spitale, përballohen nga buxheti i shtetit.

Masa e shpenzimev miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit të Rendit Publik dhe ministrit të Shëndetësisë.

Pika 3 e këtij vendimi i shtrin efektet e zbatimit nga data 1 janar 2000.

4.Pjesëmarëve të familjes së punonjësve të policisë, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, sipas ligjit nr.8030 datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" kur klasifikohen të pastrehë, u jepet kredi afatgjatë me interes 1 për qind dhe me përparësi.

5.Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë që në zbatim të këtij vendimi të nxjerrin udhëzimin e përbashkët.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta